



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1181/4 prot.

Datë 28/06/2022

V E N D I M  
Nr. 613/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                  |            |
|------------------|------------|
| Jonaid Myzyri    | Kryetar    |
| Fiorent Zguro    | Nënkryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar     |
| Anila Malaj      | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 28/06/2022 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-30932-05-26-2022, me objekt: “*Shërbim pastrimi i ambjenteve të jashtme, për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”*”, me fond limit 38.009.074 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 16.06.2022, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Silver” ShPK  
Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga “Bajram Curri”,  
Pallatet 1 Maji, Godina 7, Shk.4, Kati 1, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara  
Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1,  
1001, Tiranë

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”  
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të,

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 27.05.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-30932-05-26-2022, me objekt: “Shërbim pastrimi

*i ambjenteve të jashtme, për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”*”, me fond limit 38.009.074 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 16.06.2022, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 02.06.2022 operatori ekonomik “Silver” ShPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, ku është protokolluar me nr. 1181 prot., duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 936 prot., datë 07.06.2022 protokolluar me tonën me nr. 1181/2 prot., datë 08.06.2022 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor në lidhje me procedurën e prokurimit. Gjithashtu bashkëlidhur informacionit të mësipërm autoriteti kontraktor ka dorëzuar shkresën nr. 906/2 prot., datë 06.06.2022 me objekt “Vendim”, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Silver” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Referuar shkresës të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton se, ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Silver” SHPK dhe e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës. Konkretisht, në kthim-përgjigjen e autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka pranuar pretendimet si vijon:

“[...]

II. *Lidhur me pretendimin: “Kërkohet që dy prej punonjësve sanitare të jenë të pajisur me leje drejtimi kategoria B. Duhet të kërkoheshin dy drejtues (shoferë) mjetesh të rënda të kualifikuar me leje drejtimi kategoria D, certifikatë aftësi profesional (C.A.P) dhe me përvojën përkatëse për drejtimin e mjeteve të tilla në tabelën e stafit”, KSHA arsyeton se: Në pikën 3, të kapacitetit teknik, në dokumentet e tenderit është përcaktuar se operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon: 1 Makine teknologjike transportuese e mbetjeve urbane, me kapacitet jo me te vogel se 2 ton, me ngjeshje dhe 1 Makine per larjen e rrugeve (Autobot) te pajisur me pompe per larjen e rrugeve me presion, me kapacitet mbajtjes minimumi 7000 deri ne 8000 litra ujë. Bazuar në të dhënat e publikuara në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, rezulton se “Leje drejtimi, kategoria B” lëshohet për “automjete me masë maksimale të autorizuar jo më të madhe se 3 500 kg”. Duke iu referuar kapaciteteve mbajtëse të kërkuara për makinën teknologjike transportuese të mbetjeve urbane dhe makinën për larjen e rrugëve (autobot), rezulton se këto makina kanë masë maksimale të autorizuar më shumë se 3500 kg (e përcaktuar në kategorinë B). Për sa më sipër KSHA gjykon se 2 (dy) nga punonjësit “punonjës*

shërbimi/sanitare”, duhet të jenë të pajisur me leje drejtimi në përputhje me makineritë/pajisjet e kërkuara, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

III. Lidhur me pretendimin se”...stafi i kërkuar tek Seksioni 2.3 Kapaciteti teknik, pika 2 i përbërë nga 1 Drejtues Teknik, me profil Inxhinier kimist ose Inxhinier mjedisi, 2 Përgjegjës me profil Inxhinier kimist ose Inxhinier mjedisi dhe 8 Punonjës shërbimi/Sanitar nuk korrespondon me argumentin” KSHA arsyeton: Në argumentin lidhur me pikën 2, të seksionit 2.3, të Procesverbalit të Argumentimit, është argumentuar “...ky numër minimal punonjësish është kërkuar, duke mbajtur parasysh ndarjen në dy turne, 5 punonjës turni i parë dhe 5 punonjës turni i dytë...”. Ky argumentin i referohet stafit duke përfshirë 1 përgjegjës dhe 4 punonjës pastrimi/sanitarë për secilin turn, numër ky i cili është në përputhje me numrin e kërkuar edhe në pikën 2, të seksionit 2.3, në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në dokumentet e tenderit.

Për sa më sipër, pretendimi i ankimuesit “Silver” SHPK qëndron pjesërisht.”.

II.6. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik me Vendimin Nr. 556/2022, datë 14.06.2022 ka vendosur:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF 30932-05-26-2022, me objekt: “Shërbim pastrimi i ambjenteve të jashtme, për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza””, me fond limit 38.009.074 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 16.06.2022 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
  2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.
  3. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorëve ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Silver” SHPK se: “Lidhur me pikën “2.3 Kapaciteti teknik”, pika. 2: “Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 11 (njëmbëdhjetë) persona të punësuar, në profilet sipas tabelës si mëposhtme:

| Stafi  | Nr.     |
|--|---------|
| Drejtues Teknik- me profil Inxhinier <u>kimist</u> ose Inxhinier mjedisi | 1 (një) |

|   |                          |
|---|--------------------------|
| <b><u>Pergjegjes me profil</u></b> Inxhinier kimist ose Inxhinier mjedisi | 2 (dy)                   |
| <b><u>Punonjes sherbimi/Sanitar</u></b>                                   | 8 (tetë)                 |
| <b><u>Totali i punonjësve</u></b>   | <b>11 (njëmbëdhjetë)</b> |

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Per punonjësit punonjes sherbimi/Sanitare, te paraqitet vetem kontrate pune perkatese (dy prej tyre te jene te pajisur me leje drejtimi kategoria B).

**Në konkluzion: Kërkojme që tek SHTOJCA 8 FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT Seksioni 2.3 Kapaciteti teknik pika 2**

**Te kerkohet:**

2. Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 14 (katërbëdhjetë) persona të punësuar, në profilet sipas tabelës si mëposhtme:

| Stafi   | Nr.                       |
|---|---------------------------|
| Drejtues Teknik- me profil Inxhinier Mjedisi/Menaxhim mjedisi | 1 (një)                   |
| Drejtues mjetesesh te renda                                   | 2 (dy)                    |
| Punonjës pastrim.shërbimi                                     | 10 ( dhjete)              |
| Punonjës nduhmës në largimin e mbeturinave                    | 1 (një)                   |
| <b>Totali i punonjësve</b>                                    | <b>14 (katerbëdhjetë)</b> |

#### **KËRKOJMË**

- **Rishikimin e pikës 2 të seksionit 2.3 të Krieteve të veçanta për kualifikim përsa i përket stafit, zëvendësimin e stafit të kërkuar dhe shtimin e stafit të nevojshëm, për kryerjen e shërbimeve të kërkua.**”, komisioni vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.2 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

“ 2. Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 11 (njëmbëdhjetë) persona të punësuar, në profilet sipas tabelës si mëposhtme:

| Stafi   | Nr.                      |
|---|--------------------------|
| Drejtues Teknik- me profil Inxhinier <b>kimist</b> ose Inxhinier mjedisi  | 1 (një)                  |
| <b><u>Pergjegjes me profil</u></b> Inxhinier kimist ose Inxhinier mjedisi | 2 (dy)                   |
| <b><u>Punonjes sherbimi/Sanitar</u></b>                                   | 8 (tetë)                 |
| <b><u>Totali i punonjësve</u></b>   | <b>11 (njëmbëdhjetë)</b> |

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Për Drejtuesin Teknik, me profil - Inxhinier kimist ose Inxhinier mjedisi OE duhet te paraqes:
  - - Diplomë ose certifikatë kualifikimi me profesion /Kimist/ Inxhinier mjedisi.
  - Kontrate pune perkatese.
  - Librezë pune
  - Duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve te sigurimeve shoqerore individuale e leshuar nga e - albania.

- Ne zbatim te akteve ligjore, drejtuesi i mesiperm nuk duhet te figuroje i dy punesuar ne sektor privat apo publik. Per kete Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqerise te paraqes deklarate perkatese.
- Drejtuesi nuk duhet te jete i angazhuar ne kontrata te tjera gjate periudhes se realizimit te objektit. Per kete arsye te paraqitet deklarate perkatese nga Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqerise.
- Per punonjësit Pergjegjes me profil Inxhinier kimist ose Inxhinier mjedisi, te paraqitet:
  - Diplomë ose çertifikatë kualifikimi me profesion Inxhinier kimist ose Inxhinier mjedisi.
  - Duhet të ketë minimalisht 1 (nje) vit eksperiencë pune. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve te sigurimeve shoqerore individuale e leshuar nga e – albania.
  - Kontrate pune perkatese.
  - Librezë pune.
- Pergjegjesit nuk duhet te jene te angazhuar ne kontrata te tjera gjate periudhes se realizimit te objektit. Per kete arsye te paraqitet deklarate perkatese nga Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqerise.
- **Per punonjësit punonjes sherbimi/Sanitare, te paraqitet vetem kontrate pune perkatese (dy prej tyre te jene te pajisur me leje drejtimi kategoria B).**

Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:

| Nr | Emer Mbiemer | Profesioni | Data e fillimit te marredhenieve te punes |
|----|--------------|------------|---|
|    |              |            |   |

Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin kontratat individuale te punes si dhe diplomat e cdo punonjesi prane AK jo me vonë se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit perfundimtar.

**\*Shenim 4.1:**

Me qellim garantimin e gjithë perfshirjes, per ti dhene mundesi cdo operatori ekonomik per te marre pjese ne proceduren perkatese te prokurimit, punonjesit e mesiperm jo domosdoshmerisht duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise. Punonjesit mund te kontraktohen nga operatori ekonomik enkas per kete procedure prokurimi.

**Stafi qe do te deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor per te gene pjese e planit te zbatimit te kontrates.**

**Stafi i cili do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor, per zbatimin e kesaj kontrate, nuk duhet te jete i angazhuar ne kontrata te tjera, deri ne perfundim te kontrates. Per kete arsye te paraqitet deklarate perkatese nga Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqerise.**

**Rastet e deklaratave te rreme, do te konsiderohen kushte për skualifikim, si dhe do te ndiqet procedura per perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.”.**

III.1.2. Në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

*Shërbimi i pastrimit të jashtëm duhet të ofrohet në mënyrë sa më cilësore, pasi Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” ka në fokus cilësinë e kujdesit ndaj pacientit. Ky shërbim ka ndikim direkt jo vetëm tek përmirësimi i shëndetit të pacientit por dhe tek stafi mjekësor e jomjekësor, si dhe tek vizitorët apo qytetarët që qarkullojnë brenda territorit. Qëllimi kryesor është pasja e një ambient spitalor të pastër, brenda normave dhe kushteve që një spital duhet të ketë, eliminimi i insekteve, erës së rëndë, largimi i një grup individësh, të cilët i përdornin kontenierët si pikë mbledhje të materialeve plastike për riciklim dhe sigurisht për ti kthyer QSUT-së një ambient të pastër, relaksues për të gjithë stafin, pacientët dhe vizitorët.*

*QSUT kërkon nga Subjekti që do të ofrojë këtë shërbim, si më poshtë:*

- 1- Përgjegjësi i OE të ketë njohuri për këtë shërbim të provuar me dokumentacion;*
- 2- Grafiku i zbatimit të shërbimit për çdo muaj, pas miratimit nga A.K. i dorëzohet Operatorit Ekonomik, disa ditë përpara fillimit të muajit pasardhës;*
- 3- Subjekti, menjëherë me lidhjen e kontratës, kur të fillojë dhënien e shërbimit, duhet të dorëzojë çdo ditë/muaj (kusht i domosdoshëm), dokumentin e dorëzimit të mbetjeve në landfill me sasi të e derdhura (raportin faktik për sasi të e depozituara).*
- 4- Makineritë dhe mjetet, që duhen për të realizuar procesin e punës çdo ditë rutinë duhet të jenë si më poshtë:*

*Makina teknologjike transportuese e mbetjeve urbane, të jetë me kapacitet jo më të vogël se 2 ton, me ngjeshje. Për shkak të infrastrukturës, vend parkimeve, trafikut, këmbësorëve, vend grumbullimeve të mbetjeve urbane, si dhe godinave të shumta që ndodhen brenda territorit të QSUT-së, sygjerojmë se nuk mund të qarkullojnë automjete me volum të madh, pasi një kamion me kapacitet më të madh, do të sillte probleme të shumta gjatë procedurës së largimit të mbetjeve urbane si dhe në disa prej godinave e ka të pamundur për të qarkulluar.*

*Largimi i mbeturinave urbane bëhet në ambjentet/zonat e përcaktuara nga A.K. dhe në ambientin e hidroklovës (për tërheqjen e mbetjeve të trajtuara) me orare të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor 3 – 4 herë në ditë.*

*Sasitë e mbetjeve urbane (në kg) janë vetëm sasi orientuesë dhe NUK e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për të blerë shërbimin për t'i larguar ato. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të blejë më pak apo më shumë shërbim për evadimin e tyre brenda sasisë së parashikuar në preventiv (deri në 5,000 kg në ditë). Pra në varësi të mbetjeve urbane që QSUNT gjeneron në ditë, apo çdo proces evadimi, likuidimi do të bëhet në bazë të Dokumentit të Transferimit të Mbetjeve jo të Rrezikshme (urbane) që është i domosdoshëm për t'u mbajtur, që mund të shoqërohet dhe me dokumenta të tjera si fatura dhe/ose mandate, apo dokumenta tjera provuese të lëshuara nga landfill, apo dokumentave të mbajtura midis përfaqësues të QSUNT dhe kontraktuesit, ku janë përcaktuar sasitë e larguara nga QSUT. Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do t'i lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë përgjatë gjithë afatit të mbulimit të marrëveshjes kuadër, për 24 muaj nga data e lidhjes.*

Një makinë/autobot për larjen e rrugëve, shesheve, duhet të jetë e pajisur me pompë për larjen e rrugëve me presion, me kapacitet mbajtës, jo më pak se 7000 - 8000 litra ujë;

Si materiale për pastrim duhet të kenë; fshesa cilësore për pastrimin e rrugëve dhe shesheve dhe gjithë materialet e tjera në funksion të këtij zëri.

Pastrimi i rrjetit rrugor do të bëhet çdo ditë dhe në të dy turne, të parë dhe të dytë, si dhe larja e shesheve dhe rrugëve do të bëhet sipas grafikut mujor që do ti jepet OE nga ana A.K., kryesisht larja do të bëhet më e shpeshtë gjatë sezonit të verës ku dhe thatësira është me e madhe;

- Personeli i OE për zbatimin e kontratës është përgjegjës për njohjen dhe zbatimin e rregullave të pastrimit në QSU “Nënë Tereza” si dhe është i detyruar të :
  - Të zbatojë në punë orarin e caktuar.
  - Të ketë etikë dhe komunikim gjatë procesit të punës.
  - Të jenë bashkëpunues në rastet e nevojshme dhe të veçanta për ofrimin ekstra të këtij shërbimi.
  - Të zbatojnë me përpikmëri zërat e preventivit, sipas planit mujor të miratuar.
  - Punëtorët do të jenë të veshur me veshjet përkatëse identifikuese të pajisur me doreza, me kartat identifikuese të personelit të cilat mbulohen nga Operatori Ekonomik, si dhe do të zbatojnë rregullat e brendshme, të vendosura nga QSUNT-ja.

O.E. duhet të ketë numrin e punëtorëve dhe përgjegjësit e tyre (sipas kontratës) dhe do ti vihet lista emërore në dispozicion A.K. menjëherë me lidhjen e kontratës. Gjithashtu krahas numrit të punonjësve, duhet të paraqesë:

- a. Listën e makinerive dhe mjeteve të punës sipas kontratës dhe specifikave të përcaktuara në kontratë;
- b. Personin e autorizuar për ndjekjen e kësaj kontrate në QSU “Nënë Tereza” (këto dokumenta do të vijnë zyrtarisht të protokolluara).

Gjithashtu, për pastrimin ditor të territorit të QSUT-së është e rëndësishme ndarja e këtij territori në zonat si më poshtë, në mënyrë që mbulimi i pastrimit të territorit të bëhet në mënyrë sa më efikase dhe sa më mirë.

Pas pastrimit në orët e para të mëngjesit, në interval kohor cdo 2 orë do të ketë patrullimin e çdo punëtori të pastrimit, për zonën përkatëse. Pra duhet të jenë gjithsej **11 punëtorë** sipas zonave dhe qarkullues në gjithë territorin,

Gjithashtu, O.E. duhet të ketë si pjesë të stafit, të punësuar për QSUT-në:

- përgjegjës (që ndjek çdo ditë punën në terren)
- **shofer automjeti**
- **punëtor ndihmës në automjetin e largimit të mbeturinave**



**Zona e parë**, përfshin territorin nga Hyrja Kryesore për në QSUT, Spitali Onkologjik përreth gjithë sipërfaqes së tij, Akseleratorin Onkologjik, Godinën e Spitalit Infektiv dhe sipërfaqet përreth tij, Godina e Konsultave, si dhe parkimet e QSUT në këtë zone;

**Zona e dytë**, përfshin godinën e Djegie Plastikës (para dhe mbrapa saj), ish-Klinikat Kirurgjikale (rreth klinikave nga jashtë dhe brenda), Spitalin Polivalent, Spitalin e Sëmundjeve të Brendshme përpara dhe pjesën mbrapa, Depon qendrore të kaldajave, Mjekësinë Ligjore, si dhe parkimet e QSUT-së përreth këtyre zonave;

**Zona e tretë**, përfshin Godinën e Statistikës (ish-rektorati), të 2 godinat e Pediatriisë dhe përreth tyre, dhe parkimet e QSUT-së përreth tyre ;

**Zona e katërt**, Drejtorinë e Përgjithshme, Depon Qendrore të ujit, Spitalin Francez, Godinën e Kardiokirurgjisë dhe Kirurgjisë Vaskulare, rrugën mbrapa spitalit francez, Depoja Qendrore e Barnave deri tek hyrja/dalja e peditrisë, si dhe parkimet e QSUT-së përreth tyre;

**Zona e pestë**, përfshin Spitalin Nr.5 (Neurologjinë, Neurokirurgjinë, Shërbimin e Psikiatriisë), dhe parkimet përreth territorit të tyre;

Duhet të merren parasysh nga ana e O.E., oraret e pastrimit dhe ndarjes së turneve, si më poshtë përgjatë sezoneve

#### **1. Sezoni Pranverë -Verë**

Fillon nga ora 06:00 deri në orën në 21:00

Turni i paradites: 06:00 – 14:00 (gjysmë ore pushim për punëtorët për t'u çlodhur)

Turni i pasdites: 14:00 – 21:00

#### **2. Sezoni Vjeshtë -Dimër**

Fillon nga ora 07:00 deri në orën në 21:00 (mund ndryshohet me kërkesë të AK)

Turni i paradites: 07:00 – 15:00 (gjysmë ore pushim për punëtorët për t'u çlodhur)

Turni i pasdites: 15:00 – 21:00

Ky proces do të kryhet në dy turne, ku nuk do të mungojë për asnjë çast patrullimi i punëtorëve, për të mbajtur pastër ambientet e jashtme si sheshet, rrugët dhe trotuaret as në momentin që pjesa e stafit mund të jetë duke u çlodhur në orarin e pushimit. Operatori Ekonomik është i detyruar të pastrojë të gjithë koshat metalik me rrotullim, sa herë bëhet pastrimi i zonave të cituara.”.

III.1.3. Referuar procesverbalit “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM” të publikuar nga ana e autoritetit kontraktor në Sistemin Prokurimit Elektronik konstatohet, se është dhënë argumentimi lidhur me përcaktimin e kriterit kualifikues të dhënë në pikën 2.3.2 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, **ndërsa për specifikimet teknike nuk është dhënë asnjë argumentim**, si më poshtë:

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyres se shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic janë shërbim pastrimi. Staf i kerkuar, eshte percaktuar nga vete autoriteti kontraktor,ky numer

minimal është kërkuar duke u bazuar ne nevojën për kryerjen e shërbimeve si dhe natyrën dhe numrin e shërbimeve që kërkojnë. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës për realizimin e objektit. Operatori ekonomik duhet të disponojë një person përgjegjës (drejtues teknik) për kryerjen e shërbimeve i cili kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e shërbimit të pastrimit. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e veçanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, diploma etj janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se ky person përgjegjës është operativ pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Ky numer minimal punonjësish është kërkuar, duke mbajtur parasysh ndarjen në dy turne, 5 punonjës turni i parë dhe 5 punonjës turni i dytë.

Një përgjegjës shërbimi turni i parë dhe një përgjegjës shërbimi turni i dytë.

III.1.4. Referuar shqyrtimit të këtij pretendimi të ankimuesit autoriteti kontraktor me vendimin nr. 906/2 prot, datë 06.06.2022 është shprehur se: “III. Lidhur me pretendimin se “... stafi i kërkuar tek Seksioni 2.3 **Kapaciteti teknik**, pika 2 i përbërë nga 1 Drejtues Teknik - me profil inxhinier kimist ose inxhinier mjedisi, 2 Përgjegjës me profil inxhinier kimist ose inxhinier mjedisi dhe 8 Punonjës shërbimi/sanitar nuk korrespondon me argumentimin..”, KSHA arsyeton:

Në argumentin lidhur me pikën 2, të seksionit 2.3, në Proces-verbalit të Argumentimit, është argumentuar “... Ky numër minimal punonjësish është kërkuar, duke mbajtur parasysh ndarjen në dy turne, 5 punonjës turni i parë dhe 5 punonjës turni i dytë ... . Ky argumentim i referohet stafit duke përfshirë 1 përgjegjës dhe 4 punonjës pastrimi/sanitarë për secilin turn, numër ky i cili është në përputhje me numrin e kërkuar edhe në pikën 2, të seksionit 2.3, në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në dokumentet e tenderit: ”, duke mos trajtuar këtë pretendim të ankimuesit.

III.1.5. Në neni 77, pika 1, 2 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në

*ffjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.*

III.1.6. Në nenin 41 pika 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

ç) *mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

d) *Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”.*

III.1.7.1. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërehet, se autoriteti kontraktor ndër të tjera ka kërkuar që ofertuesit të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) drejtues teknik me profesionin **inxhinier kimist** ose inxhinier mjedisi, duke argumentuar se vendosja e këtij kriteri kualifikues është mbështetur në përcaktimet e pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, por lidhur me këtë argument ligjor Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se hartimi i këtij kriteri nuk është në përputhje me përcaktimet e nenit 41, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi kjo dispozita e sipërpërmendur ligjore në të cilën është mbështetur autoriteti kontraktor për argumentimin e kërkesës që drejtuesi teknik të jetë me profesionin inxhinier kimist nuk shprehet për kapacitetin teknik të ofertuesve në rastin e prokurimit të kontratave të shërbimeve dhe për më tepër kjo dispozite i referohet kapacitetit të ofertuesit lidhur me shlyerjen të gjitha detyrimit e maturuara të energjisë elektrike, me

mosndodhjen në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe lidhur me paraqitjen e një oferte të panvarur.

Gjithashtu nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, KPP gjykon se, përcaktimi nga ana e autoritetit kontraktor të kriterit kualifikues të dhënë në **pikën 2.3.2 të shtojcës 8** të dokumentave të tenderit në të cilin është përcaktuar se: “*Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) Drejtues Teknik, me profilin - Inxhinier kimist*“, si dhe referuar **Shtojcës 5** “*Formulari i pecifikimeve teknike*“, në të cilën nuk dalin në pah detyrat që do të kryejë drejtuesi teknik dhe roli që ka formimi profesional në profilin inxhinier kimist dhe për më tepër refruar dhe procesverbalit për argumentimin e kësaj kërkesë ku autoriteti në mënyrë konfuze shprehet se: “*Operatori ekonomik duhet të disponojë një person përgjegjës (drejtues teknik) për kryerjen e shërbimeve i cili kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e shërbimit të pastrimit.*” është një kërkesë kualifikuese e paargumentuar dhe si rrejdhim nuk përcakton nevojën që ka autoriteti kontraktor që drejtuesi teknik i ofertuesit të jetë i profilit inxhinier kimist dhe që ky kualifikim të jetë i lidhur ngushtë me realizimin me sukses të objektit të prokurimit.

Referuar kthimit të përgjigjes së autoritetit kontraktor në lidhje me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, KPP gjykon se autoriteti kontraktor në asnjë rast nuk ka argumentuar teknikisht, se si profili inxhinier kimist i drejtuesit teknik ndikon në realizimin me sukses të kontratës. Në këtë kuadër Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të heqë kërkesën që drejtuesi teknik i operatorit ekonomik ofertues të jetë i profilit inxhinier kimist në mënyrë që të rrisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret dhe specifikime teknike në lidhje me artikujt objekt-prokurimi, por në çdo rast këto specifikime teknike dhe kriteret duhet të jenë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet, si dhe duhet të jenë të justifikuara teknikisht bazuar në fakte dhe prova konkrete, pasi vendosja e kriterëve të pajustificuara shkakton kufizime dhe përjashtime tërësisht të panevojshme nga pjesëmarrja në procedurë e operatorëve ekonomikë të interesuar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Silver” ShPK, qëndron pjesërisht.

III.1.7.2. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërehet, se autoriteti kontraktor ndër të tjera ka kërkuar që ofertuesit të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre 2 (dy) përgjegjës punimesh, 8 (tetë) punonjës shërbimi ose sanitarë, ku 2 (dy) nga këta punonjës duhet të jenë me profesionin shofer, duke argumentuar se vendosja e këtij kriteri kualifikues është mbështetur në përcaktimet e pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, por lidhur me këtë argument ligjor Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se hartimi i këtij kriteri nuk është në përputhje me përcaktimet e nenit 41, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi kjo dispozita e sipërpërmendur ligjore në të cilën është mbështetur autoriteti kontraktor për argumentimin e kërkesës ku 8 (tetë) punonjës shërbimi ose sanitarë, 2 (dy) nga këta punonjës duhet të jenë me profesionin shofer nuk shprehet për kapacitetin teknik të ofertuesve në rastin e prokurimit të kontratave të shërbimeve dhe për më tepër kjo dispozite i referohet kapacitetit të

ofertuesit lidhur me shlyerjen të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, me mosnëdhjen në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe lidhur me paraqitjen e një oferte të panvarur.

Në ankesën e tij operatori ekonomik kërkon që të hiqet kërkesa e autoritetit kontraktor që të ketë të punësuar në stafin e tij 2 (dy) përgjegjës shërbimi, si dhe kërkon që të modifikohet kriteri kualifikues i përcaktuar në **pikën 2.3.2** duke shtuar kërkesën që ofertuesi të ketë të punësuar edhe 2 (dy) shoferë për drejtimin e mjeteve që janë kërkuar për realizimin e shërbimit, të shtohet numri i punonjësve sanitare, duke kërkuar nga 8 (tetë) punonjës sanitarë në 10 (dhjetë) punonjës sanitarë, si dhe të shtohet kërkesa që ofertuesi të ketë të punësuar në stafin e tij 1 (një) punëtor ndihmës në automjetin e largimit të mbeturinave, KPP gjykon se, përcaktimi nga ana e autoritetit kontraktor të kriterit kualifikues të dhënë në **pikën 2.3.2 të shtojcës 8** të dokumentave të tenderit në të cilin është përcaktuar se: *“Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 2 (dy) Përgjegjës me profil Inxhinier kimist ose Inxhinier mjedisi; 8 (tetë) Punonjës shërbimi/Sanitar, ku Per punonjës të punonjës shërbimi/Sanitare, të paraqitet vetëm kontrate pune perkatëse (dy prej tyre të jone të pajisur me leje drejtimi kategoria B).“*, si dhe referuar Shtojcës 5 *“Formulari i përcifikimeve teknike“*, në të cilin dalin në pah detyrat që do të kryejë secili prej përgjegjësve të shërbimit përgjatë 2 (dy) turneve të kryerjes së shërbimit, roli i 8 (tetë) punonjësve të shërbimit ose sanitarë gjatë 2 (dy) turneve të kryerjes së shërbimit, si dhe mënyra e kryerjes së procesit të shërbimit *(i cili përfshin largimin e mbeturinave nëpërmjet përdorimit të mjetit teknologjik transportues të mbetjeve urbane, i cili të jetë me kapacitet jo më të vogël se 2 ton, me ngjeshje, si dhe larjen e larjen e rrugëve, shesheve, duhet të jetë e pajisur me pompë për larjen e rrugëve me presion, me autobot me kapacitet mbajtës, jo më pak se 7000 - 8000 litra ujë) nëpërmjet 2 (dy) mjeteve teknologjike të cilat drejtohen nga 1 (një) shofer, si dhe përfshirja në procesin e sipërpërmendur objekt prokuirimi të 4 (katër) punonjësve për secilin nga 2 (dy) turnet që do të kryhet ky shërbim, ndërkohë që 2 (dy) shoferët kërkojnë që të jënë njëkohësisht edhe punonjës shërbimi ose sanitarë dhe ndërkohë gjatë procesit të largimit të mbeturinave me mjet teknologjik kërkojnë që ky proces të shoqërohet nga 1 (një) punëtor ndihmës në automjetin e largimit të mbeturinave, pra kriteri kualifikues i sipërpërmendur është konfuz, pasi referuar këtij kriteri kërkojnë gjithsej 11 (njëmbëdhjetë) punonjës pjesë e stafit të operatorit ekonomik ofertues, por ndërkohë referuar përshkrimit të detyrave që ka përcaktuar autoriteti kontraktor në **shtojcën 5** të dokumentave të tenderit konstatohet se për kryerjen e këtyre detyrave nevojitet që ofertuesi në stafin e tij të ketë përveç 8 (tetë) punonjësve të shërbimit ose sanitarë edhe 2 (dy) shoferë për drejtimin e 1 (një) mjeti teknologjik transportues të mbetjeve urbane, i cili të jetë me kapacitet jo më të vogël se 2 ton, me ngjeshje dhe 1 (një) autobot me kapacitet mbajtës, jo më pak se 7000 - 8000 litra ujë, si dhe nevojën që gjatë largimit të mbeturinave me mjet teknologjik, ky mjet të shoqërohet nga 1 (një) punëtor ndihmës në automjetin e largimit të mbeturinave.*

Në këtë kuadër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë qartë numrin dhe llojin e profesioneve që duhet të ketë në stafin e tij operatori ekonomik ofertues lidhur me kryerjen e detyrave të shërbimit të përcaktuara në **Shtojcën 5** *“Formulari i specifikimeve teknike”* të dokumentave të tenderit në mënyrë që të rrisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me artikujt objekt-prokurimi, por në çdo rast këto specifikime teknike dhe

kritere duhet të jenë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet, si dhe duhet të jenë të justifikuara teknikisht bazuar në fakte dhe prova konkrete, pasi vendosja e kritereve të pajustificuara shkakton kufizime dhe përjashtime tërësisht të panevojshme nga pjesëmarrja në procedurë e operatorëve ekonomikë të interesuar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Silver” ShPK, qëndron pjesërisht.

III.1.7.3. Lidhur me pretendime e ankimuesit se **“Operatori Ekonomik duhet të ketë edhe një kontratë aktive me një Landfill të liçensuar për depozitimin e mbetjeve.”**, KPP gjykon, se këto në thelb kanë të bëjë me shtim të kritereve të kualifikimit dhe jo me pretendime për modifikimin e kritereve diskriminues, të cilat do të shkaktonin skualifikim të padrejtë nga procedura e prokurimit. KPP gjykon, se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike (neni 24 e vijues i LPP-së) dhe autoriteteve kontraktore, si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit (neni 21 i LPP-së) dhe njëherazi përgjegjës për hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 110 pika 1 të LPP-së, parashikohet se *“Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”*. KPP gjykon, se që të justifikohet ligjërisht kërkimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar, duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuesin (legjitimimi pasiv), duke justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e organit administrativ për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt, ose veprimeve, pra operatori ekonomik ankimues duhet të provojë, se interesi i tij i ligjshëm është cenuar nga vendime dhe veprime konkrete (reale) të autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizmat ligjorë për kundërshtimin e kritereve për kualifikim pranë këtij të fundit, duke dhënë iu garanci të plota operatorëve ekonomikë ankimues se procedurat për fitimin e kontratave publike, do t'i nënshtrohen kushteve specifike, të cilat duhet të përmbushin parakushtin e parashikuar nga neni 77 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Në rastin konkret, KPP gjykon, se njësia e prokurimit pranë autoritetit kontraktor ka parashikuar kriterin minimal, të gjykuar të nevojshëm për vërtetimin e plotësimit të kapacitetit teknik të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Kuadri ligjor në fuqi, ka paraparë pozitën juridike të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ i shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të shprehura me akte administrative (dokumentet e procedurës së prokurimit), duke i dhënë të drejtën ligjore të shprehet mbi kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike në rast se këto të fundit janë hartuar në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe kuadrin ligjor sektorial në fuqi që rregullon kontratën objekt-prokurimi. Kompetenca e mësipërme është shprehur në disa drejtime në ligjin për prokurimin publik në fuqi, ku nën nenin 118 pika 2 gërma “b” të lex specialis parashikohet se ndër kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik, janë ato

të anulimit, plotësisht ose pjesërisht, të një veprimi ose vendimi të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato kritere kualifikimi ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj. Në rastin konkret, KPP gjykon, se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteri i kualifikimit është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, apo në rast se kriteret e kualifikimit janë hartuar në formën e kërkuar nga ligji), por mbi shtimin e kritereve të kualifikimit në një procedurë prokurimi, pasi përcaktimi i kritereve të kualifikimit sipas kërkesës nga ankimuesi, konsiderohen kritere të reja që do të rëndonin pozitat e operatorëve ekonomikë të interesuar. Sa më sipër, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, (vetëm kriteret e shprehura dhe jo ato hipotetike të kërkuara) nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Sa më sipër, për sa kohë që autoriteti kontraktor nuk ka gjykuar të vendosë kriteret e kualifikimit sipas propozimit të operatorit ekonomik ankimues, KPP në asnjë rast nuk mund të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (njësisë së prokurimit) të shtojë kritere kualifikimi në një procedurë të prokurimit publik.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 *“Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Silver” ShPK për procedurën e prokurimit *“Procedurë e hapur”*, me Nr. REF-30932-05-26-2022, me objekt: *“Shërbim pastrimi i ambjenteve të jashtme, për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”*”, me fond limit 38.009.074 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar me datë 16.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të bëjë modifikimet e të dokumenteve të tenderit në SPE, sipas konstatimeve të Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Silver*” ShPK.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**